

Pershendetje,

Lutem gjeni ne vijim përgjigjen lidhur me kerkesen tuaj:

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor zbaton skemën e sigurimit shëndetësor në Shqipëri, në përputhje të ligjit nr. 10383 datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesitshëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Siç parashikohet në nenin 10 të këtij ligji, Fondi financon paketat e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm ku përfshihen: vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor, në spitalet publike dhe jopublike për personat e siguruar.

Të dhënat për pacientët me probleme dëgjimi disponohen nga institucionet shëndetësore.

Gjithashtu ju bëjmë me dije se, në zbatim të Vendimit nr. 308 datë 21.05.2014, të ndryshuar “Për miratimin e paketave të Shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në shërbimin spitalor”, të ndryshuar, Fondi financon paketat shëndetësore, ku bën pjesë edhe paketa e Implantit Koklear për fëmijët me probleme dëgjimi. Nga kjo paketë kanë përfituar 29 pacientë. Blerja apo prokurimi i aparateve të dëgjimit nuk është objekt i punës së FSDKSH.